

VENDIM
Nr. 496, datë 16.7.2019

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2019 DHE PËR ÇAKTIMIN E ORGANIT PËRGJEGJËS, PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË MBLEDHURA NGA DONATORË TË NDRYSHËM, PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE TË DËMTUARA NGA TËRMETI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Kulturës dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, bëhet rishpërndarje fondesh, si më poshtë vijon:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor “Programe zhvillimi”, 06210, i pakësohet fondi prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekësh në shpenzime kapitale;

b) Ministrisë së Mbrojtjes, në programin buxhetor “Emergjencat civile” 10910, i shtohet fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh në shpenzime kapitale të brendshme, për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti;

c) Ministrisë së Kulturës, në programin “Trashëgimia kulturore dhe muzetë” 08220, i shtohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, për restaurimin e muzeut “Mësonjëtorja e parë shqipe”, i dëmtuar dhe aktualisht i mbyllur nga tërmeti.

2. Ministria e Mbrojtjes caktohet organ përgjegjës për përdorimin, sipas procedurave të prokurimit publik, të fondeve të mbledhura nga donatorë të ndryshëm për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti.

Ministria e Mbrojtjes të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me bashkitë e prekura nga tërmeti, për zbatimin dhe mbikëqyrjen e punimeve për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Kulturës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama